



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo - Tax Administration of Kosovo



ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS (ATK) - Divizioni i Ankesave – në përbërje të panelit shqyrtues të kryesuar nga z. Xhevdet Neziri, anëtarë të panelit: Flora Veliu anëtare dhe Bashkim Paqarizi anëtar dhe procesmbajtës, duke vendosur në çështjen administrative tatimore, sipas ankesës së subjektit “██████████” BI, me numër biznesi (NF): ██████████, me pronar ██████████, me adresë në Magjistralja Pejë - Prishtinë - Komoran, e dorëzuar në Departamentin e Ankesave me datë 11.10.2022 me nr. protokollit 439/2022, kundër vendimit mbi Njoftim-Rivlerësimet për Tatimin Shtesë, të lëshuara nga Zyra Regionale e ATK-së – Pr.2, në bazë të nenit 77 të Ligjit nr. 03/L-222, “Për Administratën Tatimore dhe Procedurat”, në seancën dëgjimore të mbajtur me datë 22.11.2022, në prezencë të palëve: z. Bujar Gjoshi pronar, Kushtrim Kastrati përfaqësues, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet pjesërisht ankesa nr.439/2022 e datës 11.10.2022, e tatimpaguesit, “██████████” BI, me numër biznesi (NF): ██████████, me pronar ██████████, me adresë në Magjistralja Pejë - Prishtinë - Komoran në mbështetje të nenit 132 paragrafi 4 i Ligjit nr. 05/L-031 Për Procedurën Administrative në lidhje me paragrafin 2 të nenit 89 të Ligjit Nr. 03/L-222 “Për Administratën Tatimore dhe Procedurat”. Njoftim Rivlerësimi i tatimit shtesë të caktuar me kontrolle, vërtetohen pjesërisht të bazuara.

II. Ndryshohen Njoftim Rivlerësimi për Tatim në të Ardhurat Personale për vitin 2018, 2019, 2021, si dhe ndryshimin e Njoftim Rivlerësimeve për Tatim mbi Vierën e Shtuar periudhat: 11/2018, 05/2019, 07/2019, 08/2021, Pjesa e mbetur pas ndryshimeve mbetet obligim për pagesë për tatimpaguesin.

III. Procedura e ankesës nuk ndërprehet obligimin e tatimpaguesit për pagesë të detyrimeve tatimore (tatim, ndëshkime dhe interes) në përputhje me nenin 9, paragrafin 1 të Ligjit Nr. 04/L-102 për Ndryshim Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat.

A r s y e t i m

Tatimpaguesi më datë 28.09.2022 ka pranuar Raportin e Kontrollit dhe Njoftim Rivlerësimet dorëzuara nga kontrolli dhe brenda afatit të përcaktuar ligjor, ka parashtruar ankesë me dt. 11.10.2022 në përputhje me nenin 77, paragrafin 2, të Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, si dhe nenin 44, paragrafin 7, të Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2010 për Zbatim të Ligjit Nr. 03/L-222 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat.

Sipas Raportit të Kontrollit veprimtaria e biznesit është kontrollimi teknik i automjeteve .
Kontrolli ka filluar me dt.17.05.2022 dhe ka përfshi këto tatime me periudha;(TVSH)
Periudhat :01/2016 – 12/2021, (PD) Periudhat: 2016 – 2021.

Në pajtim me dispozitat e nenit 77.2 të Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, personi fizike [REDAKTUAR] me numër fiskal [REDAKTUAR] me adresë Rr. Magjistrale Peje — Prishtinë — Komoran, në afatën ligjor parashtron:

Ankesë kundër Njoftim Rivlerësimeve të qarkullimit shtesë ku si rrjedhojë ka rezultuar tatimi shtesë mbi bazën e trajtimit nga transferi i se drejtës së qirimbajtëses si e ardhur bruto, trajtimit të huazimeve (kthimit të huazimit) si e ardhur bruto dhe të ardhura tjera për shkak të: konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

Përmes Njoftim Rivlerësimeve të rezultuara nga Raportit i Kontrollit të datës 28.09.2022, subjekti tatimor personi fizik [REDAKTUAR] (më tutje ankuesi), për periudhën kontrolluese 2016-2021, është ngarkuar me tatimor bazë shtesë në total prej 68.202.07€ (pa pjesën e ndëshkimeve dhe të interesit përcjellës) Provë: Raporti i Kontrollit i datës 28.09.2022, në shtojcë e ankesës.

Ankuesi konsideron se një vlerësim i këtyllë sa i përket tatimit shtesë mbi bazën e deponimeve-kthim huazimi, transferi i se drejtës së qirimbajtëses dhe mbi bazën e shitjes së gjerave personale që nuk janë aktivitet ekonomik, është i plotësisht i padrejtë, i paargumentuar dhe i pa mbështetur në dispozita ligjore të legjislativës tatimor në fuqi.

Konstatimi i gabuar i gjendjes faktike

Ne vazhdim ju ofrojmë faktet dhe dëshmitë shtese lidhur me çështjet e Lidhur me çështjen kontestuese në raportin e kontrollit tatimor të datës 28.09.2022.

1. Pika 1. Përshkrimi i biznesit (faqe 4 Pika 2)

Personi Fizik z. [REDAKTUAR] të gjitha të hyrat të cilat figurojnë në Llogarinë bankare janë të hyra nga pagat (Kompanitë e sigurimeve: Siguria, Dukagjini, Insig) për të cilat të hyra është ndaluar tatimi në burim nga kompanitë e lartcekura duke u bazuar në nenin 28 të ligjit 03/L-161. Andaj për këtë nuk kemi mbajtur dokumentacion kontabël siç kërkohet në bazë të nenit 13 të 03/L-222 dhe të nenit 17 Udhëzimit Administrativ nr. 15/2010. Për të cilat mos mbajtje të dokumentacionit e kemi përshkruar në raport me arsyetimin se tatimpaguesi është person fizik. Pas kërkesës për arsyetim të deponimeve në më datën 13/07/2022 i kemi përcjellë librin e arkës në formë elektronike përmes imell adresës zyrtare lirije.zhushi@atk-ks.org po ashtu me të njëjtën datë i kemi përcjellur edhe fizikisht në zyrë të ATK-se.

Provë: Emaili i datës 13 korrik bashkë me ditarin e arkës

Vlerësimi i bere për vitin 2018 që ka konstatuar qarkullim shtese 130,837.20€ pagës shtesë në TVSH 18,150.70€ dhe tatim shtese në fitim (PD) në vlerë prej 1,204.72€

Vlerësimi i bere vitin 2018 qarkullimit në vlerë prej 6,000.00 të datës 19/03/2018 , në vlerë prej 1,000.00 të datës 15/05/2018 dhe në vlerë prej 1,500.00 janë nga shitja e makinës personale ku makina është blerë me datë 12/02/2018 dhe është shitur mbas dy jave për arsye personale pronarit ku ju është shitur z. [REDAKTUAR] ku edhe pagesën e ka bere me transfer bankar. Pasi që këtë transaksion nuk e konsiderojmë si aktivitet ekonomik që është i përkufizuar edhe në bazë të Nenit 1 paragrafit 1.1 të ligjit 03/L-222 .

Provë: Dokumentacioni për makinën personale të shitur të Ramiz Krasniqi

Kontestojmë vlerësimin e bere si transaksion të tatueshëm të datës 14/11/2018 në vlerë prej 120,000.00€ dhe pagës shtesë në Tvsh 17,937.18€ pasi që nuk kemi të bëjmë me transaksion të tatueshëm por kemi të bëjmë vetëm me transfer të bartjes të drejtës pronësore të qira mbajtjes ,kontrata noteriale me numër LPR 2623/2018 ,e cila me kontratë mbi transferin e bartjes së qira mbajtjes është transferuar nga AKP tek z. [REDAKTUAR] me datë 26/09/2017 dhe për arsye të vështirësive financiare dhe problemeve të cilat i kishte në këtë periudhë z. [REDAKTUAR] vendos që të transferoj drejtën pronësore të qira mbajtjes tek z. [REDAKTUAR]

me date 14/11/2018 me një çmim të përgjysmuar. Po ashtu inspektorja tatimore e ka pohuar edhe në raport të kontrollit në faqen nr. 10 se kemi të bëjmë me bartje të pronës së privatizuar tek personi i lartcekur. Andaj në baze të sqarimeve të lartcekura në nuk duhet të trajtoheni si deklarues i TVSH-se në baze të nenit 7 të Ligjit 05/L-037 pasi që nuk e kalojmë pragun për tu trajtuar si deklarues i TVSH-se.

Provë: 1. Kontrata e noteri për transferin e së drejtës së qirimbajtëses

Kontrata me Alp transferi i së drejtës së qirimbajtëses

Njoftim për Atk kontratën për Transfer

Vlerësimi i bere për vitin 2019 që ka konstatuar qarkullim shtese 131,821.00€ pagesës shtesë TVSH 20,289.33€ dhe tatim shtese në fitim (PD) në vlerë prej 9,818.45€.

a) Vlerësimi si të hyra shtesë nga kthimi i huazimeve pa interes në vlerë prej 119,821.00 i cili vlerësim sipas raportit ka efekt në TVSH dhe në PD.

Nuk pajtoheni me vlerësimin e bere pasi që nuk kanë qene deponime nga ndonjë aktivitet ekonomik por deponime nga kthimi borxhit siç është edhe përshkrimi në transaksion bankar, deponimet janë bere nga personi i cili ka qene përfaqësues i autorizuar i biznesit me të cilin kemi bere marrëveshje për bashkëpunim ([REDACTED] A.SH. SHPK me numër unik 811168120 dhe [REDACTED] A SHPK me numër unik [REDACTED]8, me Pronar z. Albion Shala dhe me përfaqësues të autorizuar z. [REDACTED]) Gjatë vitit 2016-2020 bizneset e z. [REDACTED] kanë kaluar neper vështësi financiare dhe ka pasur në periudha të caktuara që kanë pasur llogarit bankare të bllokuara andaj ju ka nevojitur ndihma jone. Duke pasur parasysh që kanë pasur nevojë për ndihmë për mos e ndalur aktivitetin (blerje makina, doganim, sigurime, homologim dhe kontrollime teknike) në kemi ndihmuar gjatë kësaj periudhe me Huadhënie për mbulimin e nevojave biznese, dhe në periudhën kur i ka pasur të bllokuara llogarit bankare nga ATK z. [REDACTED] është detyruar që mjetet të deponoj në Llogarinë time me përshkrimin kthim borxhi .Huadhënia është bere pa asnjë interes shtese ,pra është kthyer shumë e njëjtë nga klienti. Prandaj nuk pajtoheni me vlerësimin e bere për arsye se me legjislacionin tatimor në fuqi për periudhën kontrolluese , e konkretisht Ligji Nr. 05/1—028 për Tatimin në të Ardhurat Personale, respektivisht me nenin 7 të këtij ligji janë saktësuar të gjitha të ardhurave bruto nga burimet që janë objekt i tatimit, ku deponimet në banke në mënyrë taksative nuk janë përfshi në kategorinë e të ardhurave bruto, që do të përfshiheshin si objekt i tatimit në vështrim të nenit 3 dhe 4 të ligjit në fjalë. Madje, as me nenin 10 paragrafi 1 pika 1.5. të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2016 për zbatimin e dispozitave të ligjit Nr. 05/1.-028, ku flitet për të ardhurat tjera nuk përmenden deponimet si kategori e të ardhurave bruto për qëllime tatimore. Siç shihet edhe me vlerësimin e raportit është punuar me standard të dyfishtë pasi që shif tabelën e draft në faqen 13 ku tërheqjet që janë tërhequr për huazim trajtohen si huazime të dhëna ndërsa kthimi i huazimit që është bere deponim me përshkrim kthim i borxhit nuk trajtohet si kthim po trajtohet si e hyr e pa deklaruar.

Te gjitha huazimet e dhëna pa interes janë të evidentuara në Llogarinë bankare përmes librit të arkës. Huazimet e mjeteve janë nga të ardhurat të krijuara përmes pagave për të cilat është ndalur tatimi në burim dhe është paguar nga punëdhënësi të bashkangjitur kenë qefti fikatën e ndaljes së tatimit në burim.

Provë: 1. Marrëveshja për Bashkëpunim (Huazimit) me AGS dhe Cargomax

Kartelat financiare 3.Njoftimi për Atk, 4. Dëshmi tjera që argumentojmë huazimet për AGS

Ankuesja konsideron se një vlerësim i këtillë sa i përket tatimit shtesë mbi bazën e deponimeve dhe mbi bazën e eksporteve, është i plotësisht i padrejtë, i paargumentuar dhe i pa mbështetur në dispozita ligjore të legjislacionit tatimor në fuqi.

Vlerësimi i bere për vitin 2020 që ka konstatuar qarkullim shtese 55,912.00€ pagës shtesë TVSH 8,709.74€ dhe tatim shtese në fitim (PD) në vlerë prej 3,385.35€.

Vlerësimi si te hyra shtesë nga kthimi i huazimeve pa interes ne vlerë prej 33,91200 i cili vlerësim sipas raportit ka efekt ne TVSH dhe ne PD .

Nuk pajtohem me vlerësimin e bere pasi qe nuk kane qene deponime nga ndonjë aktivitet ekonomik por deponime nga kthimi borxhit siç është edhe përshkrimi ne transaksion bankar, deponimet janë bere nga personi i cili ka qene përfaqësues i autorizuar i biznesit me te cilin kemi bere marrëveshje për bashkëpunim [REDACTED] s ASH. SHPK me numër unik 811168120 dhe [REDACTED] SHPK me numër unik 8111681138, me Pronar z .Albion Shala dhe me përfaqësues te autorizuar z.Latif Gashi) dhe një transfer nga Bekim Nishori për arsye se z. [REDACTED] ka pasur Llogarit bankare te bllokuara nga ATK dhe mjetet te cilat ka pasur t' ja transferoj z Bekim Nishori z. [REDACTED] i ka transferuar ne Llogarinë time për shlyerje obligimit te zAlbion Shala, gjate vitit 2016-2020 bizneset e z.Albion Shala kane kaluar neper vësh tersi financiare dhe ka pasur ne periudha te caktuara qe kane pasur Llogarit bankare te bllokuara andaj ju ka nevojitur ndihma jone. Duke pasur parasysh qe kane pasur nevojte për ndihme për mos e ndalur aktivitetin (blerje makina, doganim, sigurime, homologim dhe kontrollime teknike) ne kemi ndihmuar giatë kësaj periudhe me Huadhënie për mbulimin e nevojave biznese, dhe ne periudhën kur i ka pasur te bllokuara llogarit bankare nga ATK z. [REDACTED] është detyruar qe mjetet ti deponoj ne llogarinë time me përshkrimin kthim borxhi. Huadhënia është bere pa asnjë interes shtese ,pra është kthyer shuma e njëjtë nga klienti. Prandaj nuk pajtohem me vlerësimin e bere për arsye se me legjislacionin tatimor në fuqi për periudhën kontrolluese , e konkretisht Ligji Nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale, respektivisht me nenin 7 të këtij ligji janë saktësuar të gjitha të ardhurave bruto nga burimet që janë objekt i tatimit, ku deponimet në banke në mënyrë taksative nuk janë përfshi në kategorinë e të ardhurave bruto, që do të përfshiheshin si objekt i tatimit në vështrim të nenit 3 dhe 4 të ligjit në fjalë. Madje, as me nenin 10 paragrafi 1 pika 1.5. të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2016 për zbatimin e dispozitave të ligjit Nr. 05/L-028, ku flitet për të ardhurat tjera nuk përmenden deponimet si kategori e të ardhurave bruto për qëllime tatimore. Siç shihet edhe me vlerësimin e raportit është punuar me standard te dyfishtë pasi qe shif tabelën e raportit ne faqen 13 ku tërheqjet qe janë terhequr për huazim trajtohen si huazime te dhëna ndërsa kthimi i huazimit qe është bere deponim me përshkrim kthim i borxhit nuk trajtohet si kthim po trajtohet si e hyr e pa deklaruar.

Te gjitha huazimet e dhëna pa interes janë te evidentuara ne Llogarinë bankare përmes librit te arkës. Huazimet e mjeteve janë nga te ardhurat te krijuara përmes pagave për te cilat është ndalur tatimi ne burim dhe është paguar nga punëdhënësi te bashkangjitur keni certifikatën e ndaljes se tatimit ne burim.

Provë: te njëjtat nga pika paraprake

Vlerësimi i bere për qarkullim shtese te datës 24/12/2020 deponim i bere ne vlerën prej 8,000.00€ me përshkrim deponim shitje kockave dhe rrethojave. Nuk pajtohem me vlerësimin e bere për njohje te te hyrave si rezultat i deponimit nga shitja e sendeve personale te shtëpisë pasi qe këtë transaksion nuk e konsiderojmë si aktivitet ekonomik qe është i përkufizuar ne baze te Nenit 1 paragrafit 1.1 te ligjit 03/1=222.

Vlerësimi bere vitin 2020 qarkullimit ne vlerë prej 2,000.00 te datës 08/05/2020 janë nga shitja e makinës personale dhe pagesën e ka bere ne mënyrë te pjesshme ne Llogari bankare . Nuk pajtohem me vlerësimin e bere për njohje te te hyrave si rezultat i deponimit nga shitja makinës personale pasi qe këtë transaksion nuk e konsiderojmë si aktivitet ekonomik qe është i përkufizuar edhe ne baze te Nenit 1 paragrafit 1.1 te ligjit 03/L-222.

6. Vlerësimi i bere për vitin 2021 qe ka konstatuar qarkullim shtese 32,301.00€ pagës shtesë TVSH 5,078.14€ dhe tatim shtese ne fitim (PD)ne vlere prej 1,565.79€.

Vlerësimi i bere për qarkullim shtese te datës 19/08/2021 ne vlerën prej 8,600.00€ dhe tatim shtese TVSH ne vlere prej 1,311.86€ me përshkrim bankar "Deponim [redacted] nga shitja e veturës golf" i cili deponim është ne bankën Ekonomike.

Nuk pajtohem me vlerësimin e bere për njohje te te hyrave si rezultat i shitjes se veturës personale. Pasi qe këtë transaksion nuk e konsiderojmë si aktivitet ekonomik qe është i përkufizuar ne baze te Nenit 1 paragrafit 1.1 te ligjit 03/L-222.

Provë: Dokumentet e makinës personale te shitur Valdrin Kasniqit

Ne tabelën ne vijim do te paraqesim ne format komulativ transaksionet bankare te z. Bujar Gjoshit e cila dëshmon se te gjitha te hyrat ne Llogarinë bankar janë te deklaruar dhe tatimuaara (ndalur tatimi ne burime nga punëdhënësi ps Dukagjini, Siguria, Insigni, Ilirira), për shitjen e aksioneve është deklaruar dhe paguar tatimi burim ne vitin 2016.

Departamenti i Ankesave në bazë të nenit 95 të Ligjit nr. . 05/L -031 Mbi Procedurat e Përgjithshme Administrative ka organizuar seancën e dëgjimit më datë 22.11.2022, në të cilën të pranishëm ishin të gjitha palët e fuara në mënyrë të rregullt për veq inspektorese së kontrollit.

Tatimpaguesi në të drejtën e fjalës në tërësi e mbështetën ankesën e shkruar.

Tatimpaguesi potencon se vetura në vlerë prej 8,500.00€ ka qenë pronë personale dhe mjetet janë pranuar me transfer bankar, kurse qarkullimi në vlerë prej 120,000.00€, janë të hyra nga shitja e lokalit afarist të privatizuar nga AKP, në vitin 2017, të cilin lokal e kemi shit nën çmim për shkak të disa problemeve financiare. Sa i përket huazimeve për biznesin "Allmakes Global", interesi i biznesit ka qenë se biznesi [redacted] është agjension i sigurimeve dhe biznesi Allmakes i ka siguruar të gjitha veturat me sigurimin e veturave te biznesi [redacted]. Biznesi Allmakes ka qenë i bllokuar nga ATK-ja dhe subjekti [redacted] i ka ndihmuar financiarisht duke i paguar pagesë në Doganë dhe pagesa tjera.

Në periudhën 2020 janë dy vetura që janë shitur për mes llogarisë bankare si dhe me kontratë te noteri, si dhe kockat e përdorura të cilat kanë qenë në oborrin e shtëpisë.

Inspektorja e kontrollit edhe pse është lajmëruar për mes Njoftimit për seancë për me e-mailit me dt.15.11.2022, nuk ka prezantuar në seancë. Më dt. 06.12.2022, ka ardhë Inspektorja Lirije Zhushi me Udhëheqësin e ekipit Bekim Gashi për skjarime në lidhje me Raportin e Kontrollit. Me shitjen e hotelit është deklaruar dhe ka kryer obligimet tatimore. Hotelit ka qenë në emër të [redacted]. Mjetet që i ka kthye [redacted] nuk i plotëson kriteret për huadhënie pasi që nuk kemi dëshmi. Deponimet i kemi trajtuar sipas Ligjit 03/L-222, për Administratën Tatimore dhe Procedurat Neni 19 paragrafi 3 dhe neni 30.paragrafi 3.2, i Udhëzimit Administrativ nr.15/2010.

Departamenti i Ankesave pas shqyrtimit të ankesës, pas dëgjimit të dy palëve në kontest gjatë seancës dëgjimore dhe pas vlerësimit të të gjitha provave në shkresat e lëndës, bëri ballafaqimin e tyre dhe vendosi që ankesa e tatimpaguesit është pjesërisht e bazuar.

Dispozitivi i këtij Vendimi të Departamentit të Ankesave është i mbështetur në faktet në vijim: Divizioni i Ankesave konstaton se vlerësimi zyrtar nga ana e ATK-së është bërë komfor nenit 14; 15 dhe 19 të Ligjit Nr. 03/L-222 për "Administratën Tatimore dhe Procedurat".

Divizioni i Ankesave bazuar në dosjen që disponon për shqyrtimin e rastit, konstaton se vlerësimi i kontrollit është bërë bazuar në provat e disponueshme materiale të cilat janë siguruar sipas kërkesës zyrtare: Raportin e Kontrollit, Njoftim Vlerësimet pas kontrollit, Fletat e punës, Librit të blerjes, Librit të shitjes, Ankesën e tatimpaguesit, Llogaritë Bankare për periudhat 2019 – 2021, DUD-ve të importeve të subjektit "[redacted]" dhe subjektit "[redacted]", për periudhën 2018, Kontratë për transferin e të drejtës

së qiramarrjes, Kontratë për shitjen dhe bartjen e pronës, si dhe pretendimeve ankimore, nga të njëjtat nxjerr konstatimin, se ATK-Drejtoria Rajonale, Prishtina 2, ka kryer kontrollin tek subjekti "██████████" me NF: ██████████ (PD) – dhe ka rezultuar tatim shtesë për periudhat tatimore 2018– 2021, në vlerë prej 15,974.31 dhe (TVSH) - tatimi shtesë në vlerë prej 52,227.74€, pa ndëshkime dhe interes (vlera të marra nga raporti i kontrollit).

Pra, Divizioni i Ankesave e mbështet pjesërisht vlerësimin e kontrollit edhe në faktin se kontrolli ka bërë verifikimin e dokumentacionit të shtjelluar sipas paragrafit 1, 2 dhe 3 të nenit 19 të ligjit nr. 03/L – 222 për "Administratën Tatimore dhe Procedurat" dhe nenit 29 të Udhëzimit Administrativ 15/2010 për zbatimin e Ligjit nr. 03/L-222, të cilat dispozita parashohin që Vlerësimi i Drejtorit të Përgjithshëm të bëhet sipas gjykimit të tij ose saj më të mirë dhe do të bazohet në të gjitha provat që ai ose ajo ka në dispozicion dhe në bazë të të cilave nga kontrolli është vërtetuar se tatimpaguesi ka nën dekluar pjesërisht tatimin e tij.

- Kontestin e tatimpaguesit për qarkullimi shtesë për periudhën 2018, nga shitja e veturës në vlerë prej 8,500.00€, Divizioni i Ankesave pas analizës së dokumentacionit në dosje vërteton se kontrolli nuk ka vlerësuar drejtë sipas dispozitës ligjore të Ligjit 05/L-037, për Tatimin në e vlerës Shtuar Neni 59 paragrafi 3, 4 dhe neni 75 paragrafi 1.1 i Udhëzimit Administrativ nr.03/2015

Neni 59 paragrafi 3 dhe 4 citon:

3. Skema e marzhës aplikohet për furnizimet nga tregtari i tatueshëm i mallrave të dorës së dytë, punëve artistike, artikujve të koleksionistëve ose antikitetëve, ku këto mallra janë furnizuar për të, brenda Kosovës, nga personat si në vijim:

3.1. një person jo i tatueshëm;

3.2. personi tjetër i tatueshëm, nëse furnizimi i mallrave nga ai personi tjetër i tatueshëm është i liruar sipas neneve 27 dhe 28 të këtij ligji;

3.3. tregtari tjetër i tatueshëm, nëse TVSH-ja është zbatuar në furnizimin e mallrave nga tregtari tjetër i tatueshëm në pajtueshmëri me këtë skemë të marzhës.

4. Marzha e fitimit të tregtarit të tatueshëm duhet të jetë e barabartë me diferencën ndërmjet çmimit të shitjes të ngarkuar për mallrat nga tregtari i tatueshëm dhe çmimit të blerjes së atyre mallrave. Shuma e tatueshme në lidhje me furnizimin e mallrave të dorës së dytë, punëve artistike, artikujve të koleksionistëve dhe antikitetëve, duhet të jetë marzha e fitimit e bërë nga tregtari i tatueshëm, pa shumën e TVSH-së që lidhet me marzhën e fitimit.

Kështu që vlera e shitjes së automjetit sipas llogarisë bankare 8,500.00€, minus vlera e blerjes sipas DUD-it - 4,689.22€ = 3,811.00€ marzha e fitimit, andaj $3,811.00/118\% = 3,229.66 \times 18\% = 581.33$ vlera e TVSh-së llogaritur, me të cilën tatimpaguesi duhet të ngarkohet për periudhën 11/2018.

Nga vlera e shitjes 8,500.00€ i zbrisim vlerën e blerjes në total 4,689.22€, të cilën vlerë duhet ta regjistrojmë tek zëri shitjet e përjashtuara, kurse vlera prej 3,229.66€ duhet ta regjistrojmë tek zëri shitje e tatueshme, këto ndryshime do të paraqesim në periudhën 11/2018 për TVSH-në, gjithashtu kemi rritje të hyrave shtesë në vlerë prej 715.54€, sipas ankesave për periudhën 2018 për TAP.

Sa i përkety kontestit për qarkullimi shtesë për shitjen e lokalit afarist në vlerë prej 120,000.00€, është vlerësuar drejtë nga kontrolli, mirëpo te zëri i blerjeve kontrolli nuk e ka vlerësuar drejtë, sepse çmimin e kostos e ka marrë vlerën e shitjes 120,000.00€, e jo vlerën e blerjes 223,581.00€.

Divizioni i Ankesave pas analizës së dokumentacionit në dosje e në veçanti dokumentit "Kontratë për shitjen dhe bartjen e pronës", Nr.6715 datë 26.09.2017, ku është potencuar

çmimi i blerjes nënkupton 223,581.00€, objekt i kontratës ka qenë Shitja dhe bartja e pronës – NSH "Gërmia" Shitorja Fushë Kosovë.

Kontrolli vlerën e blerjes e ka marrë të barabartë me vlerën e shitjes me arsyetimin se vlera e blerjes është më e madhe se vlera e shitjes, andaj Divizioni i Ankesave bazuar në dokumentacionin në dosje si "Kontratën për Transferin e të Drejtës Qiramarrësit", nr.2623/2018, datë 14.11.2018, vlera e shitjes 120,000.00€, si dhe llogarit e bankës së Bujar Gjoshit (të hyrën prej 120,000.00€), ka vërtetuar se tatimpaguesi vërtet se e ka shit nën çmimin e blerjes, këtë fakt e arsyeton me Njoftimin për Kontratën Për Transferin e të drejtës së Qiramarrësit LRP. Nr.2623/2018 Ref.nr.525/2018 të datës 14.11.2018, të cilat fakte gjenden në dosjes e D/A-ve.

D/A-ve vërtetohet se këtë transaksion e lejon edhe dispozita ligjore e Ligjit 05/L- 028 për Tatimin në të Ardhurat Personale Neni 31 paragrafi 7 dhe 8, i cili nen citon:

7. Fitimet dhe humbjet kapitale nuk do të pranohen për pasurinë e grupuar, në kategorinë 2 dhe kategorinë 3, të parapara me nenin 20, paragrafin 3, nën paragrafin 2 dhe nën paragrafin 3 të këtij ligji, të përvetësuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

8. Humbja kapitale nënkupton humbjen që e pëson tatimpaguesi nëpërmjet shitjes apo ndonjë forme tjetër të tjetërsimit të pasurisë kapitale, përfshirë pasurinë e tundshme dhe të patundshme dhe letrat me vlerë.

Nga ky nen Divizioni i Ankesave konstaton se kemi të bëjmë me shitjen kapitalit e cila i takon grupit të kategorisë së parë.

Andaj Divizioni i Ankesave bazuar në faktet e lartshënuara bënë korrigjimin e deklaratës vjetore për periudha 2018, të zëri 62 - Blerja apo kostoja e prodhimit, ku vlera e blerjes sipas D/A-ve është $223,581.00 \times 5\%$ zhvlerësim për një vit = 11,179.05 zhvlerësimi për 6 mujorin e dytë të viti 2017 dhe 6 mujorin e parë të viti 2018, që do të thotë se $223,581.00 - 11,179.00 = 212,401.95\text{€}$, vlera e blerjes që duhet të regjistrohet të zëri 62 i deklaratës vjetor 2018.

Tatimpaguesi ka pas të hyra në total vlerën prej 147,589.00€, së bashku me shitjen e veturës, shitjen e pronës së privatizuar dhe të hyra nga qiraja dhe ka mbërritur limitin me qenë deklarues i Tvsh-së sipas dispozitës ligjore të Ligjit 05/L-037 për TVSH-ë neni 7 paragrafi 2.

Kontrolli gjatë përpilimit të deklaratës vjetore për periudhën 2018 për Tatimin në të Ardhurat Personale për të hyrat nga qiraja ka zbritur tatimin e mbajtur në burim nga qiratë sipas Nenit 39 i Ligjit 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale.

Sa i përket kontestit të tatimpaguesit për qarkullimin shtesë prej 112.718.47€ pa tvsh-ë për periudhën 2019, nga deponimet e Latif Gashit në llogarinë e Bujar Gjoshit në vlerë prej 101,543.22€ pa TVSh-ë dhe transferet nga KS [redacted] për qira mujore për periudhën 2019 në vlerë prej 11,175.25€ pa tvsh-ë – Divizioni i Ankesave pas analizës së dokumentacionit në dosje vërtetohet se kontrolli pjesërisht ka vlerësuar qarkullim shtesë bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit 03/L-222, neni 19 paragrafi 3, dhe neni 30, paragrafi 3.2 i Udhëzimit Administrativ nr.15/2010.

Tatimpaguesi në ankesë pretendon se këto deponime kanë qenë pjesërisht kthim i huazimeve për pagesën e doganës akcizës dhe TVSh-së me rastin e importeve nga subjekti "Cargomax Prishtina" Shpk (pagesa 28,743.59) dhe subjektit "[redacted]" Shpk, (pagesa 10,143.56) të paguara nga [redacted] gjatë periudhës 2018, vlera totale e pagesës ka qenë 38,871.14€, për mes llogarisë bankare.

Tatimpaguesi "[redacted]" Shpk dhe subjektit "[redacted]" Shpk, për periudhën 2019, për mes përfaqësuesit Latif Gashi në llogarinë e bankës së Bujar Gjoshit ka deponua mjete në vlerë prej 119.821.00€.

Divizioni i Ankesave bazuar në shënimet e lartë cekura vjen në përfundim se kontrolli nuk i ka marrë për bazë pagesat e Doganës, Akcizës dhe TVSh-së gjatë periudhës 2018, të bëra nga [redacted] për subjektet "[redacted]" Shpk në vlerë prej 28,727.53€ dhe subjektit

"Allmakos Global Service" Shpk, në vlerë prej 10,143.56€, këto pagesa pala i dëshmon me pagesat për mes llogarisë bankare "Banka Ekonomike" për periudhat 2016 – 2021, Marrëveshje për Bashkëpunim në mes të [redacted] dhe subjekteve [redacted] Shpk dt.10.02.2016 e cila është në emër të personit Bujar Gjoshit. Tatimpaguesi në ankesë ka sjell si dëshmi DUD-at e subjekteve [redacted] Shpk, periudhat 01 – 12/2018, andaj Divizioni i Ankesave bazuar në shënimet e lartshënuara e bënë thyerjen e pagesave nga [redacted] dhe deponimeve nga përfaqësuesi [redacted] në vlerë prej $38,871.14/118\% = 32,941.15\text{€}$ pa tvsh-ë, e cila vlerë duhet të zbritet nga qarkullim shtesë në periudhën 2019 për TVSh-ë dhe Tatimin në të Ardhurat Personale. Gjithashtu edhe të hyrat nga transferet e qirasë nga K S Dukagjini Divizioni i Ankesave vërteton se kontrolli të hyrat nga qiraja i ka trajtuar në deklaratën vjetore për periudhën 2019 për Tatimin në të Ardhurat Personale, për të hyrat nga qiraja ka zbrit tatimin e mbajtur në burim nga qiratë sipas Nenit 39 i Ligjit 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale.

Sa i përket kontestit të tatimpaguesit për qarkullimin shtesë në vlerë prej 48,387.46€, pa TVSh-ë, për periudhën 2020, për deponimet nga përfaqësuesi [redacted] të hyrat nga shitja e kockave, shitja e makinës personale për periudhën 2020 – Divizioni i Ankesave pas analizës së dokumentacionit në dosje vërteton se kontrolli ka vlerësuar me të drejtë për të hyrat nga deponimet bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit 03/L-222, për Administratën Tatimore dhe Procedurat Neni 30 paragrafi 3.2, i Udhëzimit Administrativ, për të hyrat nga shitja kockave dhe veturës kontrolli ka vlerësuar sipas dispozitës ligjore të Ligjit 05/L-028, për Tatimin në të Ardhurat Personale. Neni 10 paragrafi 1.

Sa i përket kontestit të tatimpaguesit për qarkullimin shtesë në vlerë prej 28,211.00€, pa TVSh-ë për deponimet nga [redacted], për shitjen e veturës, për shitjen e Inventarit, të hyrat nga qiraja për periudhën 2021 – Divizioni i Ankesave pas analizës së dokumentacionit në dosje vërteton se kontrolli ka vlerësuar me të drejtë për të hyrat nga deponimet bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit 03/L-222, për Administratën Tatimore dhe Procedurat neni 19 paragrafi 3 dhe Neni 30 paragrafi 3.2, i Udhëzimit Administrativ, për të hyrat nga shitja e inventarit, kontrolli ka vlerësuar sipas dispozitës ligjore të Ligjit 05/L-028, për Tatimin në të Ardhurat Personale. Neni 10 paragrafi 1.

Kurse për të hyrat nga shitja e veturës Divizioni i Ankesave bënë korrigjimin e deklaratës tatimore për TAP periudha 2021, dhe TVSh-ë periudha 12/2021. Kontrolli për shitjen e veturës e ka ngarkuar tatimpaguesin me vlerën e shitjes 8,600.00€ duke e nxjerr me koeficient TVSh-në brenda, 7,288.13€ vlera e tatishme dhe tvsh-ja 1,311.86€.

Divizioni i Ankesave bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit 05/L-028, për Tatimin në të Ardhurat Personale neni 31 paragrafi 5 dhe neni 33, paragrafi 2.2, bënë pranimin si kosto 80%, e vlerës së shitjes, çka do të thotë se vlera e shitjes 8,600.00€ x 80% = 6,880.00€ vlera e blerjes në mungesë të dokumentit blerës.

Kontrolli në rastin konkret është dashtë të aplikoi TVSh-në e llogaritur në skemë të marzhës Sipas Neni 59 paragrafi 3 dhe 4 citon:

3. Skema e marzhës aplikohet për furnizimet nga tregtari i tatueshëm i mallrave të dorës së dytë, punëve artistike, artikujve të koleksionistëve ose antikitetëve, ku këto mallra janë furnizuar për të, brenda Kosovës, nga personat si në vijim:

3.1. një person jo i tatueshëm;

3.2. personi tjetër i tatueshëm, nëse furnizimi i mallrave nga ai personi tjetër i tatueshëm është i liruar sipas neneve 27 dhe 28 të këtij ligji;

3.3. tregtari tjetër i tatueshëm, nëse TVSH-ja është zbatuar në furnizimin e mallrave nga tregtari tjetër i tatueshëm në pajtueshmëri me këtë skemë të marzhës.

4. Marzha e fitimit të tregtarit të tatueshëm duhet të jetë e barabartë me diferencën ndërmjet çmimit të shitjes të ngarkuar për mallrat nga tregtari i tatueshëm dhe çmimit të blerjes së atyre mallrave. Shuma e tatueshme në lidhje me furnizimin e mallrave të dorës së dytë, punëve artistike, artikujve të koleksionistëve dhe antikitetëve, duhet të jetë marzha e fitimit e bërë nga tregtari i tatueshëm, pa shumën e TVSH-së që lidhet me marzhën e fitimit.

Kështu që vlera e shitjes së automjetit sipas llogarisë bankare 8,600.00€, minus vlera e blerjes 6,880.00€ = 1,720.00€ marzha e fitimit, andaj $1,720.00/118\% = 1,457.62 \times 18\% = 262.37$ vlera e TVSh-së llogaritur, me të cilën tatimpaguesi duhet të ngarkohet për periudhën 12/2021.

Nga vlera e shitjes 8,600.00€ i zbrisim vlerën e blerjes në total 6,880.00€, të cilën vlerë duhet ta regjistrojmë tek zëri shitjet e përjashtuara, kurse vlera prej 1,457.62€ duhet ta regjistrojmë tek zëri shitje e tatueshme, këto ndryshime do ti paraqesim në periudhën 08/2021 për TVSh-në, gjithashtu ke rritje të hyrave shtesë në vlerë prej 1,049.49€, sipas ankesave për periudhën 2021 për TAP.

Të gjitha ndryshimet e njoftim vlerësiemve bëhen sipas njoftim vlerësimeve të përpunuara në sistemin e Teknologjisë Informative të ATK-së, në "Sigtas" pas ankese, ndërsa pjesa tjetër e vlerësimit mbetet e pa ndryshuar, sipas vlerësimit të kontrollit.

19.6. Tatimpaguesi ka barrën e provës lidhur me të provuarit se kryerja e ndonjë vlerësimi nga Drejtori i Përgjithshëm është e gabuar dhe barrën për të provuar se shumta e ndonjë vlerësimi të tillë është e pasaktë.

Në bazë të gjendej së konstatuar duke pasur parasysh të gjitha provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, e në përputhje me nenin 132, paragrafi 4, i Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031, Divizioni i Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Bazuar në nenin 3 të Ligjit Nr. 04/L-102 "Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr. 03/L-222, pala e pakënaqur ka të drejtë që brenda afatit tridhjetë (30) ditësh, nga dita e pranimin të vendimit të Departamentit të Ankesave, ta kundërshtojë këtë vendim tek Divizioni Fiskal i Departamentit Administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

DIVIZIONI I ANKESAVE NË PRISHTINË
Nr: 439/2022 datë 12/12/2022

Vendimi t'iu dorëzohet :

1. Tatimpaguesit
2. Administratës Tatimore

Udhëheqës i Divizionit të Ankesave
Skender Krasniqi

Kryesuesi i rastit
Xhevdet Neziri

